

## **KËRKESË**

**Nr. 2290/6, datë 29.3.2021**

### **PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Vorë, Bashkia Vorë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi dhe “ndërtesë”, me funksion jo banimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, bazuar në çmimet mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit, për vitin 2016.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Vorë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 133 336 461 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Etjen Xhafaj**













